



BASHKIA  
TIRANË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

Data:08.11.2022

**Drejtuar:** Operatorit Ekonomik “A R J E I L” sh.p.k, me NUIS K31320002C me adresë:  
Tiranë, Kamëz, Tiranë.

\* \* \*

Procedura e prokurimit:E hapur,marrëveshje kuadër me një operator ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 mujor.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-43305-09-26-2022

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:: “Blerjeplakadhebordura”, me afat lëvrimi nga lidhja e kontratës/kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor sipas kërkesës, në bazë të marrëveshjes kuadër, me fond limit 30.762.500 (tridhjetëmilion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dymijë e pesëqind) lekë pa TVSH.

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet):Buletini i Njoftimeve Publike Datë03.10.2022,Numri 135.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. Operatori ekonomik: “A R J E I L” sh.p.k, me NUIS K31320002C, dhe me ofertë ekonomike26.148.000(njzet e gjashtëmilion e njëqind e dyzet e tetëmijë)lekë pa tvsh.
2. Operatori ekonomik: “BASHKIMI/L”sh.p.k, me NUISJ64103475Q, dhe me ofertëekonomike0 lekë.
3. Bashkimi i operatorëve ekonomik: “MURATI D” sh.p.k, me NUIS K42003004T, dhe “NAMIKU-08”sh.p.k, me NUIS K81722001V me ofertë ekonomike27.264.160 (njzet e shtatëmilion e dyqind e gjashtëdhjetë e katërmijë e njëqind e gjashtëdhjet)lekë pa tvsh.

4. Operatori ekonomik: “K.TURJA” sh.p.k, me NUIS K81314014A, dhe me ofertë ekonomike 30.451.600 (tridhjetëmilion e katërqind e pesëdhjetë e njëmijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh.

Është skualifikuar Operatori ekonomik i mëposhtëm:

1. “BASHKIMI/L” sh.p.k, me NUIS J64103475Q, me adresë: Fier Lushnje LUSHNJE Autostrada Lushnje-Fier km 4, Pasuria me nr 104/18 ne zonen kadastrale 3268.

Arsyet e skualifikimit janë:

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument sipas kritereve të përcaktuara në DST.

2. BOE “MURATI D” sh.p.k, me NUIS K42003004T, dhe “NAMIKU-08” sh.p.k, me NUIS K81722001V me adresë: Rruga Kavajes, Ish- Kombinati Ushqimor, Godine 1- katëshe, Tiranë, dhe Kamëz Rruga Korabi, Ambient i hapur, zk. 2066, nr. pasurie 43/154.

Arsyet e skualifikimit janë:

- Nuk përmbush pikën 2.1 gërma b) të kriterëve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet se: *“1. Ofertuesi duhet të paraqesë: b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; pasipërfaqësuesi i B.O.E në sigurimin e ofertës nuk ka specifikuar pjesëmarrjen sipas B.O.E sic parashikohet në nenin 88 pika 2 të V.K.M Nr.258 Dt.19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.*
- Nuk përmbush pikën 2.1 gërma a) të kriterëve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet se: *1. Ofertuesi duhet të paraqesë: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8” Operatori sipas plotësimit të pikave 6-10 të seksionit B të shtojcës 8 janë vetëdekluar sipas referuarit në pikën 5 të seksionit B ku parashikohet se : “Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala “konkurrent” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:*
  - a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor;*
  - b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .”*
- Nuk përmbush pikën 2.2.1 të **Kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë** ku parashikohet se: *Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001-2015 ose ekuivalente (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë), pasi njëri prej anëtarëve të B.O.E më konkretisht NAMIKU-08 nuk ka paraqitur asnjë dokument për përmbushjen e kësaj pike.*
- Nuk përmbush pikën 2.2.2 të **Kapacitetit ekonomik dhe financiar** ku parashikohet se: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktuara në nenin 41 të Ligjit Nr.10091,*

profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, indryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit, pasi njëri prej anëtareve të B.O.E më konkretisht NAMIKU-08 nuk ka paraqitur asnjë dokument për përmbushjen e kësaj pike.

Nuk përmbush pikën 2.3.1 të **Kapacitetit teknik** ku parashikohet se: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.*

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

- a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara pasi njëri prej anëtareve të B.O.E më konkretisht NAMIKU-08 ka paraqitur Faturë Shoqëruesetë mallit dhe jo faturë tatimore e fiskalizuar.*

3. “K.TURJA” sh.p.k, me NUIS K81314014A me adresë: Durrës Bubq BUDULL Budull, pranë Urës së Gjolës.

Arsyet e skualifikimit janë:

Nuk përmbush pikën 2.1 gërma a) të kritereve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet se: “1. Ofertuesi duhet të paraqesë: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8”

- *Operatori ka zgjedhur opsionin JO në pikën 6 të seksionit B ku parashikohet se: Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër; rrjedhimisht O.E në këtë mënyrë pohon përgatitjen e ofertes në bashkëpunim.*
- *Nuk përmbush pikën 2.1 gërma a) të kritereve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet se: “1. Ofertuesi duhet të paraqesë: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8”*
- *Operatori ka deklaruar (plotësuar) gabim pikën 7 të seksionit B ku parashikohet se: Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit). Pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga O.E rezulton se operatori ka ofertuar si ofertues i vetëm.*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm është identifikuar si i suksesshëm: Operatori ekonomik: “A R J E I L” sh.p.k, me NUIS K31320002C, dhe me ofertëekonomike 26.148.000 (njëzet e gjashtëmilion e njëqind e dyzet e tetëmijë) lekë pa tvsh.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Herion Rrapaj**